VENDIM
Nr.587, datë 7.7.2010

PËR MONITORIMIN DHE KONTROLLIN E NIVELIT TË ZHURMAVE NË QENDRAT URBANE DHE TURISTIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë, nëpërmjet strukturave të tyre qendrore dhe rajonale, të marrin të gjitha masat për monitorimin e situatës në qendrat urbane e turistike në vend, duke ushtruar kontroll në të gjitha veprimtaritë e subjekteve fizike dhe juridike, të cilat janë burim zhurme.

2. Ministria e Shëndetësisë të angazhojë Institutin e Shëndetit Publik për kryerjen e matjeve dhe vlerësimin e nivelit të zhurmës, sipas udhëzimit të përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave e të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3. Strukturat e njësive të qeverisjes vendore, në bazë të nenit 8 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të zbatojnë të gjitha kriteret ligjore në fuqi dhe masat e mbrojtjes nga zhurmat, duke aplikuar dhënien e lejeve për lokalet e ndryshme, sipas këtij përcaktimi:

3.1 Për mjediset e hapura orari i lejimit të veprimtarive, për ditët e premte dhe të shtunë, të jetë nga ora 19.00 deri në orën 24.00, ndërsa për ditët e tjera të javës të jetë nga ora 19.00 deri në orën 23.00, sipas normave të lejuara të zhurmës, të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

3.2 Për mjediset e mbyllura, veprimtaria të lejohet pa kufizime orari, duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës të përcaktuar në udhëzimin e përbashkët nr.8, datë 27.11.2007 të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Shëndetësisë "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

4. Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturave të Policisë së Shtetit, të marrë të gjitha masat për mbështetjen e organeve e të strukturave shtetërore që ushtrojnë monitorimin e kontrollin e zhurmave në mjedis, si dhe të monitorojë zbatimin e orarit të përcaktuar në piken 3.1 të këtij vendimi.

5. Strukturat vendore të Policisë së Shtetit dhe strukturat ekzekutive të njësive të qeverisjes vendore mbështesin Inspektoratin e Mjedisit, me kërkesën e tij, për zbatimin e vendimeve të marra nga ky Inspektorat ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë në kundërshtim me ligjin. Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministri i Brendshëm përcaktojnë me udhëzim të përbashkët procedurat e bashkëpunimit ndërmjet strukturave përgjegjëse në zbatimin e vendimeve të marra nga Inspektorati i Mjedisit.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministria e Shëndetësisë, brenda një afati 6-mujor nga hyrja në fuqi e këtij vendimi dhe në zbatim të nenit 20 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", të marrin të gjitha masat për hartimin e miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave.

7. Pas miratimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Menaxhimin e Zhurmave, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.9774, datë 12.7.2007 "Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis", Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të miratojë programin dhe

udhëzimet përkatëse, të cilat u dërgohen organeve të qeverisjes vendore, që do të realizojnë, brenda vitit 2011, hartëzimin e zhurmës në nivel vendor, si dhe hartat strategjike të zhurmës, në nivel kombëtar.

8. Për bashkërendimin e punës dhe marrjen e masave për zbatimin me efikasitet të këtij vendimi, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, nëpërmjet strukturave të tyre qendrore dhe vendore, në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore dhe nën mbikëqyrjen e prefektit të qarkut, të ngrenë grupet përkatëse të punës, në nivel vendor.

9. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Brendshme, prefektët e qarqeve dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha